



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **IX-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024.**

Seanca mbahet më **25.10.2024 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:


R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë: 20.09.2024,
3. Pyetje dhe përgjigjeje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së të datës 09.10.2024,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të lokaleve komunale kompanisë NLP KRM "Ambienti" njësia në Klinë (ref. nga ekz),
6. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2024 (ref.drejt.fin),
7. Diskutim i Raportit të SMPK-së (ref. nga ekz),

01Nr. 06-34323 2024
Klinë, më 15.10 2024



Anëtar i Kuvendit
Tunë Dedaj



Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010. Član 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i član 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komisija, predsedavajući Skupštine Opštine, vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se svi članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da učestvuju na 9 redovnu radnu sednicu Skupštine za 2024 godinu.

Sednica se održava 25.10.2024 (petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.

U vezi sa pitanjem neučešća na sednici, referisete se na odredbu člana 39. ZLS.

Za ovu sednicu predložen je ovaj:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sednice održane: 20.09.2024.
3. Pitanja i odgovori,
4. Razmatranje i usvajanje preporuka KPF-a od 09.10.2024.
5. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke za davanje opštinskog prostora preduzeću NLP KRM „Ambienti“ jedinica u Klini (ref. iz pr.),
6. Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju za period januar-septembar 2024. godine (ref. drrejt.fin),
7. Diskusija o Izveštaju SMPK (ref. od pr.),

01Br. 06-39303 2024
Klina, 15.10 2024



Najstariji u Skupštini
Tunë Dedaj

Tunë Dedaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Për/To/Za :	Komitetin për Politikë e Financa
Kopje :	Kuvendin Komunal
Nga/From/Od :	Drejtoria për Buxhet e Financa - z.Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	Z. Zenun Elezaj – kryetar i KK Klina
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për shqyrtimin e Raportit Financiar janar-shtator 2024
Data :	2.10.2024




Përshëndetje të nderuar!

01 Nr.No. 901 - 32 989 129
Data-Dat: 02.10.2024

Me anë të kësaj letre përcjellëse kërkojmë shqyrtimin e Raportit Financiar janar-shtator 2024 .

Me respekt!



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 173/2021

në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut përkitazi me rastin e ndërtimit të fabrikës së çimentos në Dollc, komuna e Klinës

Drejtuar:

Z. Liburn Aliu, ministër
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Z. Zenun Elezaj, kryetar
Komuna e Klinës

Kopje:

Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 2 shtator 2024

Qëllimi

1. Ky Opinion pasqyron qëndrimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit në lidhje me respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut, si dhe parandalimin e cenimit të tyre si rrjedhojë e procesit të ndërtimit të fabrikës së çimentos në fshatin Dolle të komunës së Klinës. Opini i mëton të sjellë në vëmendjen e autoriteteve kompetente, në këtë rast Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm: MMPHI) dhe Komunës së Klinës, rëndësinë e respektimit të plotë të të drejtave të qytetarëve duke vënë në fokus balancimin e drejtë në mes të interesave të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e ekonomik të vendit në fushën e industrisë minerale.
2. Avokati i Popullit, konkretisht nëpërmjet këtij Opinioni, synon të vërë në vëmendje përgjegjësitë dhe detyrimet pozitive të shtetit për respektimin e së drejtës së qytetarëve për vendimmarrje për çështje mjedisore në vendin ku jetojnë dhe për përmbushjen e të drejtave nga shteti pa afektuar të drejtat e tjera të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet e aplikueshme në fuqi.
3. Opini i bazohet në ankesën e parashtruar nga një grup i qytetarëve nga fshatrat Dolle, Gremnik dhe Dresnik të komunës së Klinës, përcjell me petitionin e nënshkruar nga 3901 qytetarë, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e fabrikës së çimentos në fshatin Dolle të Klinës, me pretendimin se ndikon negativisht në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Baza ligjore

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”, ndërsa në nenin 135, paragrafi 3 përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe liritë të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
5. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);
 - të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
 - t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);
 - Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe

avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3).”

Përmbledhja e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

6. Avokati i Popullit në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 12 mars 2021 e kishte pranuar ankesën e z. Ahmet Gashit dhe të gjashtë të tjerëve (z. Sylejman Gashi, z. Jeton Kalludra, z. Faton Berisha, z. Josip Dedaj dhe z. Enver Gashi, bashkë me peticionin e nënshkruar nga 3901 qytetarë të tjerë), parashtruar kundër Komunës së Klinës dhe kundër MMPHI-së për mosinformim publik përkitazi me mbarëvajtjen e procesit të ndërtimit të fabrikës së çimentos në Dollc të Klinës.
7. Sipas pohimeve të ankuesve dhe dokumentacionit të paraqitur në IAP, ankuesit më 21 shkurt 2020 kishin parashtruar peticion të nënshkruar nga 3901 qytetarë, drejtuar Kuvendit Komunal të Klinës, nëpërmjet të cilit kishin shprehur kundërshtimin për ndërtimin e fabrikës së çimentos në fshatin Dollc, për shkak të ndikimit negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Parashtruesit e ankesës operimin e kësaj fabrike e konsiderojnë të dëmshëm për mjedisin, shkatërrimin e florës dhe faunës, trashëgimisë kulturore, në veçanti me pasoja të pariparueshme për shëndetin publik. Parashtruesit e ankesës kanë thënë se më 9 mars 2021, operatori ekonomik (OE) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit kishin organizuar debatin publik në hapësirat e restorant “Villa Park Ujvara” në Klinë dhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM, për të cilin parashtruesit e ankesës ankoreshin se u ishte mohuar tërthorazi e drejta për pjesëmarrjen e të gjithë të interesuarve në debat, për shkak të mosinformimit efektiv në shpalljen e publikuar.
8. Parashtruesit e ankesës më 30 qershor 2020 kishin ushtruar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Pejë, kundër drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë, me dyshimin se mund të ishte kryer vepra penale: *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*, lidhur me rastin. Më 15 shtator 2021 Prokuroria Themelore në Pejë, me Aktvendimin PP/Inr.97/2020, kishte hedhur poshtë kallëzimin penal me arsyetimin se nuk ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se ishte kryer vepra penale në fjalë.
9. Më 17 mars 2021, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (tani MMPHI) kishte nxjerrë Vendimin Nr.21/35/1-ZSP, me të cilin e kishte pajisur me Pëlqim Mjedisor kompaninë për veprimtarinë *Fabrikë për prodhimin e çimentos në lokalitetin Dollc, Komuna e Klinës*.
10. Më 22 prill 2021, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me letër kryetarit të komunës së Klinës, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar informata për veprimet të cilat i kishte ndërmarrë dhe ato që planifikoheshin të ndërmerreshin, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesit.
11. Më 7 maj 2021, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga kryetari i komunës së Klinës, me të cilën ishte informuar si në vijim:

“Me rastin e pranimit të shkresës suaj që ka të bëjë me ankesën, nr.173/2021 të parashtruar nga Ahmet Gashi dhe (6) të tjerë kundër Komunës së Klinës, që ndërlidhet me peticionin e qytetareve, nr.01-350- 6830/2020 të datës 21.02.2020 dhe vendimet e nxjerra në Kuvendin e Komunës së Klinës, ju sqarojmë si në vijim:

Kuvendi i Komunës së Klinës pas pranimit të petitionit, nr.01-350-6830/2020 të datës 21.02.2020 të nënshkruar nga rreth 4000 qytetare të Komunës së Klinës të cilët i kanë kundërshtuar veprimet lidhur me ndërtimin e fabrikave të çimentos në Komunën e Klinës, me kërkesën e kryetarit të Komunës si dhe mbi 1/3 së anëtareve të Kuvendit është thirrur takim i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës së Klinës. Takimi i jashtëzakonshëm është mbajtur më datën 05.03.2020 në të cilin takim është marre vendim që të anulohen të gjitha pëlqimet dhe dokumentet tjera urbanistike që janë dhënë lidhur me guroret për furnizim me lende të pare për fabrikat e çimentos, vendimi nr. 01-06-8940/2020.

Me rastin e aprovimit të vendimit në afat ligjor vendimi është nënshkruar nga kryesuesi ku më pastaj nga ana e shërbimit për pune të kuvendit të Komunës është protokolluar dhe më datën 11/03/2020 është përcjell tek MAPL-ja për vlerësim të ligjshmërisë së tij, po ashtu më 11.03.2020 është konfirmuar opranimi i tij nga ana e MAPL-së. [...]

Duke marre parasysh se një pike e vendimit është konsideruar nga ana e kuvendit e panevojshme, në seancën e datës 26.06.2020 është nxjerr vendim për plotësim ndryshim të vendimit nr.01-06-8940/2020 të datës 05.03.2020, përkatësisht heqjen e pikës 3 të vendimit baze. [...]

Edhe pas komunikimeve të shumta me autoritetin mbikëqyrës përkatësisht MPL më datën 18.01.2021 Komuna Klinës ka pranuar një shkresë të MPL dhe Ministrisë së linjës Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ku thuhet se:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Klinës, nr.01-06-8940/2020 i datës 11.03.2020, si dhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Klinës, nr.01-06-15082/2020 i datës 02.07.2020 nuk mund të prodhojnë efekt juridik pasi që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Përveç kësaj është theksuar së vendimet e tilla të Kuvendit të Komunës nuk janë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 53 paragrafi 1.

Lidhur me çështjen e organizimit të debateve me publikun nga ana e operatorit ekonomik pa ndonjë njoftim të Komunës së Klinës, ju njoftojmë së Komuna më rastin e Miratimit të dokumenteve të planifikimit duke përfshirë Planin Zhvillimor si dhe Hartat Zonale ka organizuar paraprakisht debate publike në përputhje me legjislacionin në fuqi deri në miratimin e këtyre dokumenteve të planifikimit në Kuvendin e Komunës.

Debati për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VMN) organizohet dhe mbahet në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nr.03/L-214, të cilat dispozita parashohin së Plani dhe organizimi i debatit është përgjegjësi e aplikuesit, i cili do të përgatitë një plan, i cili do t'i dërgohet Ministrisë për pëlqim, ku caktohet lokacioni, data e debatit publik, mekanizmat dhe kohën e informimit publik si dhe lokacionet ku ekspozohen Raporti i VNM, përmbledhja jo-teknike e raportit të VNM dhe propozimi i vendimit. Debati publik nuk mbahet përderisa aplikuesi nuk ka marr pëlqimin e Ministrisë, më shkrim.

Aplikuesi në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor informojnë publikun, nëpërmes mjeteve të informimit, ku përfshihet shpallja më së paku në një gazetë ditore, për datën, lokacionin, kohën e debatit publik dhe sigurimin e dokumenteve të parapara.”

12. Më 30 shtator 2021, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit nëpërmjet adresës elektronike i ishte drejtuar Komunës së Klinës me kërkesë për përcjelljen e dokumenteve të cilave u ishte referuar Komuna e Klinës në përgjigjen e datës 7 maj 2021 drejtuar Avokatit të Popullit.
13. Më 12 tetor 2021, Komuna e Klinës ia kishte përcjellë IAP-së dokumentacionin e kërkuar.
14. Më 14 nëntor 2022, 4 banorë të fshatrave Gremnik dhe Dolle të komunës së Klinës (në cilësinë e ankuesve) ishin takuar me Avokatin e Popullit dhe me kryetaren e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut. Në këtë takim ankuesit kishin shpalosur shqetësimet dhe kundërshtimet e tyre lidhur me planifikimin e ndërtimit të fabrikës së çimentos në Klinë, për shkak të ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit jetësor, përfshirë dëmtimin e florës, faunës dhe burimeve ujore. Ankuesit kishin pohuar se qëndrimet e tyre nuk ishin marrë parasysh nga autoritetet qendrore dhe as lokale, pavarësisht së drejtës së garantuar për pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.
15. Më 9 mars 2023, Avokati i Popullit kishte vizituar fshatrat Gremnik dhe Dolle të komunës së Klinës dhe ishte takuar me grupin e përfaqësuesve të fshatrave dhe me mbi 50 banorë të tjerë, për t'i dëgjuar nga afër ankesat e tyre. Banorët kishin shpalosur kundërshtimin e tyre për ndërtimin e fabrikës së çimentos në lokacionin e fshatit Dolle, me pretendimin se parcelat e planifikuara ishin në afërsi të fshatrave Gremnik dhe Dresnik dhe me zonën urbane të qytetit të Klinës. Sipas tyre, operimi i gurorëve për furnizim me lëndë të parë për fabrikën e çimentos është i dëmshëm për shëndetin e njeriut, degradimin mjedisor, shkatërrimin e florës dhe faunës, burimeve ujore nëntokësore dhe trashëgiminë kulturore. Banorët ishin ankuar edhe për administrimin jo të rregullt të procesit, duke theksuar mungesë informimi nga Komuna për mbarëvajtjen e procedurave përkitazi me çështjen. Avokati i Popullit së bashku me banorët kishin vizituar vendin ku planifikohet të ndërtohet fabrika e çimentos. Më 24 prill dhe më 11 korrik 2023 përfaqësuesja e Avokatit të Popullit i ishte drejtuar me letër sekretarit të MMPHI-së, nëpërmjet së cilës i kishte kërkuar informata lidhur me veprimet të cilat kjo ministri i kishte ndërmarrë për rastin konkret si dhe përcjelljen e dokumentacionit relevant.
16. Më 23 qershor 2023, Avokati i Popullit kishte pritur në takim parashtruesit e ankesës, të cilët ishin ankuar se u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Nenin 52(2) të Kushtetutës. Sipas tyre, në procesverbalin e debatit publik, i cili ishte mbajtur më 9 mars 2021, nuk ishin përfshirë komentet dhe qëndrimet e disa banorëve pjesëmarrës në debat dhe të njëjtët pretendonin se procesverbali ishte falsifikuar. Falsifikimin e pretenduar të procesverbalit të dëgjimit publik, më 22 qershor 2023 ankuesit e kishin adresuar në Policinë e Kosovës – Stacioni Klinë. Ankuesit kishin pohuar se OE ishte pajisur edhe me lejen për gurthyes në të njëjtin lokacion.
17. Më 17 gusht 2023, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë ministrit të MMPHI-së, nëpërmjet së cilës i kishte kërkuar informacione lidhur me të gjitha veprimet që kjo ministri i kishte ndërmarrë lidhur me rastin, të përcjella me dokumentacionin përkatës.
18. Më 4 shtator 2023, parashtruesit e ankesës kishin njoftuar se më 7 gusht 2023 Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin A.nr.1962/2020, me të cilin kishte hedhur poshtë si të palejueshme padinë e MAPL-së kundër së paditurës - Komunës së

Klinës, e cila me padinë e 13 nëntorit 2020 kishte kërkuar anulimin e Vendimit nr. 06-8940/20 të datës 5 mars 2020, duke iu referuar nenit 82.2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale.

19. Më 7 nëntor 2023, Avokati i Popullit i kishte ftuar në takim përfaqësuesit e MMPHI-së, të Komunës së Klinës, parashtruesit e ankesës në IAP dhe përfaqësuesit e kompanisë për ndërtimin e fabrikës, në të cilin ishte diskutuar lidhur me veprimet e ndërmarra deri më tani nga institucionet përgjegjëse përkitazi me rastin, si dhe përparësitë dhe shqetësimet e palëve të interesit në aspektin e të drejtave të njeriut.
20. Pas takimit të lartpërmendur, më 13 nëntor 2023 përfaqësuesi i MMPHI-së, nëpërmjet adresës elektronike ia kishte përcjellë IAP-së dokumentet e nxjerra nga MMPHI-ja lidhur me fabrikën për prodhimin e çimentos në Klinë, si në vijim:
 - Vendimin nr.7570-2/19, datë 14 maj 2020, për aprovimin e kërkesës së kompanisë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk, për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën “Përqeva Perëndimore” – Klinë, dhe Vendimin nr.7568-2/19, datë 14 maj 2020, për aprovimin e kërkesës së kompanisë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk, për Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e mergelëve në karrierën “Gremniku Lindor”, Klinë dhe listat e distribuimit.
 - Vendimin nr.36/2021, datë 22 mars 2021, për pajisje me Pëlqim Mjedisor të kompanisë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk, për veprimtarinë: gurthyesin me seperacion, bazë për prodhimin e asfaltit dhe bazë për prodhimin e betonit në lokalitetin Dolle, Komuna e Klinës [...].
 - Vendimin nr. nr.35/2021, datë 22 mars 2021, për dhënien e Pëlqimit Mjedisor për kompaninë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk, për veprimtarinë “Fabrikë për prodhimin e çimentos në lokalitetin Dolle, Komuna e Klinës [...].
 - Raporti i mbikëqyrjes inspektive, datë 11 maj 2022, dhe Procesverbalin mbi inspektimin e kryer më 5 maj 2020.
 - Vendimin nr.2804/22, datë 17 maj 2022, me të cilin pezullohet Vendimi nr.35/2021, i datës 22 mars 2021, për dhënien e Pëlqimit Mjedisor për kompaninë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk, për veprimtarinë “Fabrikë për prodhimin e çimentos në lokalitetin Dolle, Komuna e Klinës.
21. Më 11 dhjetor 2023 përfaqësuesja e kompanisë “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” shpk ia kishte përcjellë IAP-së Aktvendimin AA.nr.843/2023, datë 24 nëntor 2023, me të cilin ishte miratuar si e bazuar ankesa e palës së interesuar “Wallingford International-Kosovo L.L.C.” (për t’ia lejuar dhe njohur të drejtën e palës së interesuar si palë në procedurë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë), ndërsa Aktvendimi A.nr.1962/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, i datës 10.9.2023, ishte prishur dhe lënda i ishte kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe në rivendosje.
22. Avokati i Popullit ia kishte përcjellë edhe informatat në portalet informative dhe në media, të cilat kishin raportuar lidhur me ngjarjet e zhvilluara përkitazi me iniciimet për ndërtimin e fabrikës së çimentos në Klinë, përfshirë edhe protestat e mbajtura të qytetarëve kundër ndërtimit të kësaj fabrike.

Baza ligjore

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut për rastin konkret

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit, të së drejtës së pronës, të mbrojtjes së mjedisit [...].

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. [...].”

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

“1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

“1. Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.

2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.”

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj

Neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Konventa e Arhusit (Konventa për të Drejtën e Publikut për Informacion, Pjesëmarrje në Vendimmarrje dhe të Drejtën për t’iu Drejtuar Gjykatës, për Çështje që Lidhen me Mjedisin)

Neni 1 [Objektivi]

“Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e së drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, çdo Palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t’iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.”

Analiza ligjore

23. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit përkitazi rastin A.nr.173/2021 bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e zbatueshme në vend, me KEDNj-në dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
24. Avokati i Popullit në këtë opinion analizon zbatimin e detyrimeve ligjore të shtetit nga autoritetet përgjegjëse, në lidhje me zbatimin efektiv të së drejtës së qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje në çështjet mjedisore. Më tej opinioni pasqyron standardet vendore dhe ndërkombëtare dhe detyrimin kushtetues dhe ligjor të autoriteteve për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe të së drejtës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit.
25. Avokati i Popullit me këtë opinion nuk i trajton çështjet e ngritura në organet e drejtësisë, përkitazi me këtë rast.

Pjesëmarrja në vendimmarrje në çështjet mjedisore

26. Përgjegjësinë për mjedisin jetësor, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në vazhdim: Kushtetuta) me nenin 52 (1) parimisht e përcakton ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetin, ruajtjen e mjedisit jetësor dhe trashëgiminë kombëtare, si obligim i të gjithëve, që i përfshinë të gjitha subjektet (obligim i çdo personi). Kushtetuta i vë në përgjegjësi dhe obligim institucionet e pushtetit publik, që të angazhohen me qëllim të sigurimit dhe të garantimit që çdo person ta ketë mundësinë e ndikimit në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin punon dhe jeton, neni 52(2): “*Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.*”
27. Madje, Kushtetuta, nëpërmjet dispozitave të saj, nuk ka lënë asnjë hapësirë e cila do t’u mundësonte komunave shmangien nga obligimi për informim dhe për përfshirje të publikut në vendimmarrje. Neni 124 i Kushtetutës [Organizimi dhe Funksonimi i Vetëqeverisjes Lokale] specifikon decidivisht: “[...] Komunat gëzojnë shkallë të lartë të

vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.”

28. Avokati i Popullit sjell në vëmendje se konkretizimi i dispozitave kushtetuese, të cilat parimisht e rregullojnë përgjegjësinë për mjedisin jetësor dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje, rregullohet me Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe me ligjet e tjera që kanë të bëjnë me mjedisin. Ligji në nenin 6, paragrafi 12, përcakton: *“Parimi i qasjes së publikut në informata. Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.”* Më tej neni 57 i ligjit obligon organet vendimmarrëse të sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për: [...]. 2. *Publiku informohet përmes mjeteve të informimit për procedurën e marrjes së vendimeve dhe merr pjesë në dhënien e mendimit, komentëve dhe sugjerimeve institucionit kompetent dhe me kohë informohet për vendimin e marrë në pajtim me ligj.”*
29. E drejta e pjesëmarrjes në vendimmarrje, e drejta e qasjes në informata dhe e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin, rregullohen me aktin normativ me karakter ndërkombëtar - Konventën për të Drejtën e Publikut për Informacion, e njohur si Konventa e Arhusit. Konventa obligon autoritetet që ta respektojnë të drejtën e publikut për të pasur qasje në informata lidhur me mjedisin, që mbahen nga autoritetet publike, përfshirë informacione mbi infrastrukturën, politikat dhe masat e ndërmarra. Respektivisht, sipas Konventës, autoritetet duhet t’i ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura për t’u mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit që të ofrojnë komente dhe propozime përkitazi me projektet, planet dhe programet mjedisore, dhe ato komente të merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes. Edhe pse Konventa nuk është e ratifikuar, tri parimet e saj janë të përfshira në tërë legjislacionin mjedisor të vendit.
30. Deklarata e Rios, e vitit 1992, në Parimin 10 të saj shprehimisht definojnë: *“Çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të [...] çdo individ duhet të ketë akses të duhur në informacionin në lidhje me mjedisin që mbahet nga autoritetet publike dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. [...] Do të sigurohet akses efektiv në procedurat gjyqësore dhe administrative, duke përfshirë korrigjimin dhe mjetet juridike.”*
31. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 68 [Informimi publik dhe konsultimi], saktësisht potencon informimin e pjesëmarrësve në takimet publike komunale për aktivitetet e Komunës. Ndërsa, përveç këtyre takimeve, siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni, komunat janë të obliguara t’i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e Komunës.
32. Avokati i Popullit vëren se një ndër parimet në të cilat bazohet Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor është edhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje. Për më tepër, ligji nëpërmjet nenit 4 promovon: *“1.2. proces demokratik të pjesëmarrjes publike [...] në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor; 1.3. transparencë të plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor; 1.5. mundësi të barabarta të zhvillimit [...] mjedisor për të gjithë qytetarët; 1.6. cilësi të lartë të jetesës dhe sistemeve të*

qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve; 1.8. pjesëmarrje publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike.”

33. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Aktgjykimin Nr. KI 56/09 (datë 22 dhjetor 2010, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit) ka konstatuar se parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur rast të dëgjoheshin nga institucioni publik (pala kundërshtarë) dhe ta thoshin mendimin e tyre lidhur me çështjet që kanë ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë. Gjykata Kushtetuese, në mungesë të informacionit dhe të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, ka konstatuar shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës, e drejtë e garantuar me nenin 52 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
34. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), nëpërmjet praktikës gjyqësore të saj, ka konstatuar se mbrojtja e mjedisit trajtohet në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), në nenin 2 [E drejta për jetën] dhe në nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]. Në lidhje me të drejtën e qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje, GjEDNj-ja, sipas praktikës së saj, ka konstatuar se kur shtetet vendosin për politika të ndërlikuara që lidhen me mjedis dhe ekonomi, në procesin e vendimmarrjes së pari duhet të përfshihen hulumtime dhe studime të mirëfillta, për t'u mundësuar palëve që paraprakisht t'i parashikojnë dhe vlerësojnë efektet e atyre veprimeve që mund ta dëmtojnë mjedisin dhe t'i cenojnë të drejtat e individëve, dhe për t'u mundësuar shteteve që të vendosin ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshme kundërtënëse (*Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Gjykata, në rastin *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, ka theksuar rëndësinë e qasjes së publikut në konkluzionet e studimeve të tilla dhe në informata që do t'u mundësonin atyre ta vlerësonin rrezikun të cilit i ekspozohen, është jashtë çdo dyshimi.
35. Rëndësia e respektimit të aspekteve procedurale në vendimet që lidhen me mjedisin janë theksuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në Rekomandimin 1614 (miratuar më 27 qershor 2003) për mjedis dhe të drejtat e njeriut, i cili në paragrafin 9 thekson: “*Asambleja u rekomandon Qeverive të shteteve anëtare: [...] “iii. t'i mbrojnë të drejtat procedurale të individëve për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit siç përcaktohet në Konventën e Aarhusit.”*
36. Agjenda 2030¹ dhe Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16 [Paqe dhe drejtësi, institucione të forta], në qëllimin 16.7 ka përcaktuar të mundësohet vendimmarrje reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet; promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin konkret

¹ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) janë një thirrje globale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur mjedisin dhe klimën e tokës dhe për të siguruar që njerëzit kudo që janë të mundë të gëzojnë paqe dhe prosperitet. Kosova, edhe pse nuk është nënshkruese e Agjendës 2030, zbatimi i Agjendës 2030 dhe i OZhQ-së në Kosovë është siguruar përmes miratimit të një rezolute parlamentare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në janar 2018.

37. Në rastin konkret, parashtruesit e ankesës pretendojnë se organizatorët e debatit publik – OE-ja dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - nuk i kanë respektuar procedurat ligjore për ofrimin e qasjes efektive në informata të qytetarëve lidhur me mbajtjen e debatit publik, i cili ishte realizuar më 9 mars 2021 me prezencë fizike dhe në mënyrë virtuale, në restorantin “Villa Park Ujvara”, në periferi të komunës së Klinës. Parashtruesit e ankesës pretendonin se si pasojë e mosinformimit efektiv për mbajtjen e debatit publik, në debat nuk kishin marrë pjesë shumë qytetarë të interesuar. Njoftimi për mbajtjen e debatit publik ishte bërë përmes formave joefektive, nuk ishte publikuar në ueb-faqet zyrtare të Ministrisë dhe Komunës së Klinës, as në mediat lokale në Klinë, dhe po ashtu as në tabelën e njoftimeve në hyrje të objektit të Komunës së Klinës. Për më tepër, sipas tyre, komentet dhe qëndrimet e qytetarëve, të cilët kishin marrë pjesë në këtë debat publik, nuk ishin përfshirë në procesverbalin e takimit. Në lidhje me pretendimet e lartpërmendura, MMPHI-ja nuk ka arritur ta dëshmonte të kundërtën, ngase nuk ishte përgjigjur në shkresat e Avokatit të Popullit dhe nuk ia kishte përcjellë Avokatit të Popullit informatat përkitazi me veprimet e ndërmarra lidhur me organizimin e debatit publik të lartshënuar.
38. Parashtruesit e ankesës, në cilësinë e përfaqësuesve të qytetarëve të fshatrave Dolle, Gremnik dhe Dresnik, përveç peticionit të adresuar, më 7 maj 2021 i ishin drejtuar përsëri me kërkesë MMPHI-së, nëpërmjet së cilës e kishin njoftuar atë se iniciativa qytetare kishte në dispozicion një grup profesionistësh mjedisorë dhe kishin kërkuar bashkëpunim me ekspertët e ministrisë për t'i bërë vlerësimet për rreziqet dhe dëmet e mundshme nga ndërtimi dhe operimi i fabrikës. Parashtruesit e kërkesës kanë pohuar se asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje në peticionin dhe as në kërkesat e tyre drejtuar ministrisë. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të ankesës, Avokati i Popullit, siç është theksuar më lart, i ishte drejtuar MMPHI-së me kërkesë për informata, por nuk kishte marrë përgjigje.
39. Duke marrë parasysh rrethanat e sipërpërmendura, nga të cilat rezulton se jo të gjithë qytetarët e interesuar kishin pasur rast të dëgjoheshin në debatin publik i mbajtur më 21 mars 2021, në mënyrë që t'i shprehnin mendimet e tyre në lidhje me çështjet që ata vlerësonin se do të kishin ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë, Avokati i Popullit vlerëson se një praktikë e tillë nuk është në harmoni me standardet ligjore dhe as ndërkombëtare të analizuara më lart. Ndërsa në lidhje me pretendimet e ngritura nga parashtruesit e ankesës, përkitazi me falsifikimin e procesverbalit të takimit të debatit publik, Avokati i Popullit nuk lëshohet në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi rasti është adresuar në organet e ndjekjes.
40. Në vazhdim, bazuar në informatat dhe në dokumentacionin në dispozicion, Avokati i Popullit vëren se në rastin konkret MMPHI-ja nuk kishte arritur t'u ofronte qytetarëve informata të bazuara në hulumtime dhe në studime të mirëfillta, në mënyrë që paraprakisht të njoftoheshin në përpikëri me ndikimin në mjedis, rreziqet dhe dëmet eventuale dhe t'i parashikonin dhe vlerësonin efektet dhe pasojat e veprimeve dhe të vendimeve të cilat drejtpërsëdrejti, apo në mënyrë të tërthortë, mund t'i cenonin të drejtat e tyre.
41. Avokati i Popullit, bazuar në garancitë kushtetuese dhe ligjore, gjithashtu bazuar në standardet ndërkombëtare dhe në praktiken gjyqësore të GjEDNj-së, të analizuara më sipër, që garantojnë të drejtën e çdo personi ta ketë mundësinë e ndikimit në vendimet që

kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin jeton dhe vepron, vlerëson se parashtruesit e ankesës dhe qytetarët e tjerë të interesuar nuk e kishin gëzuar nivelin e kërkuar për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ata jetojnë, siç garantohet me nenin 52.2 të Kushtetutës.

Mbrojta e mjedisit jetësor

42. Duke qenë se shqetësimi kryesor i parashtruesve të ankesës qëndron se ndërtimi i fabrikës së çimentos dhe veprimtaria e saj në lokacionin e planifikuar për ndërtim, e cila ka afërsi me zonat e banimit përreth, do të ketë ndikim në degradimin mjedisor, rrezikimin dhe ndikimin negativ në shëndetin e njeriut, ndotjen e ajrit, shkatërrimin e florës dhe faunës, të burimeve ujore nëntokësore dhe të trashëgimisë kulturore, Avokati i Popullit, bazuar në mandatin që ka dhe kompetencat kushtetuese dhe ligjore, vlerëson të nevojshme t'i sjellë në vëmendje të autoriteteve shtetërore rëndësinë jetike dhe kujdesin e shtuar intensiv për mjedisin e shëndetshëm jetësor, në mënyrë që secili që gëzon autoritet dhe ka ndikim mbi proceset e planifikuara të zhvillimit ekonomik, të cilat prekin mjedisin jetësor, t'i respektojë në përpikëri të gjitha **standardet obligative kushtetuese dhe ligjore**.
43. Avokati i Popullit në këtë kapitull të opinionit, përkitazi me mbrojtjen e mjedisit jetësor, ka për qëllim t'i vërë në rikujtim detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes mjedisore në proceset dhe interesat e zhvillimit ekonomik, për të cilat duhet të punohet me kujdes të veçantë dhe me qasje në respektimin e të drejtave të njeriut, në këtë rast në respektimin e së drejtës së secilit për të jetuar në mjedis të sigurt, të pastër dhe të shëndetshëm.
44. Prandaj Avokati i Popullit e vlerëson t'i nevojshme të sjellë në vëmendje standardet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat duhet të aplikohen me seriozitet, dhe assesi të tejkalohen, në proceset zhvillimore të cilat mund të kenë ndikim negativ në mjedisin jetësor dhe në shëndetin e njeriut. Në vazhdim do të listohen të drejtat e garantuara me instrumente vendore dhe ndërkombëtare dhe me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, përkitazi me mbrojtjen e mjedisit jetësor, rëndësinë qenësore për parandalimin e dëmeve mjedisore dhe të dëmeve në shëndetin e njeriut, të cilat mund të rezultojnë të pariparueshme në të ardhmen.
45. Kushtetuta, mbrojtjen e mjedisit jetësor, përveçqë e garanton në kapitullin e të Drejtave dhe Lirive Themelore, mbrojtjen e mjedisit e rendit në mesin e vlerave të rendit kushtetues, i cili në nenin 7 [Vlerat] përcaktohet si në vijim: *1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet ..., respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit [...].* Parimet të cilat sipas dispozitave kushtetuese paraqesin vlerat më të rëndësishme, padyshim se pjesë e tyre është edhe mbrojtja e mjedisit.
46. Kushtetuta, duke ia dhënë fuqinë e parimit imperativ, në nenin 52, paragrafi 1, shprehimisht përcakton përgjegjësinë e të gjithëve, pa përjashtim, për mbrojtjen e mjedisit jetësor duke theksuar: *"Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin."* Më tej, me të njëjtin nen, në paragrafin 3, Kushtetuta ua vë përgjegjësinë primare institucioneve publike, që në procesin e marrjes së vendimeve të merret parasysh ndikimi në mjedisin jetësor:

“Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.”

47. Konkretizimi i dispozitave kushtetuese, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, rregullohen me ligje dhe akte përkatëse juridike për të garantuar se të drejtat janë të efektshme dhe të respektohen në një mënyrë të qëndrueshme. Përgjegjësitë dhe obligimet pozitive të autoriteteve publike për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut, konkretisht për mbrojtjen e mjedisit jetësor, mbrojtjen e shëndetit publik të qytetarëve, mbrojtjen e natyrës, rregullohen me ligjet në fuqi, si në vijim:

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, me të cilin harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian, dhe rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, qëllimi i të cilit është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. 2. Ky ligj përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, përmes integritimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, i cili ka për qëllim t’i përcaktojë kompetencat, procedurat dhe përgjegjësitë e institucioneve për pajisjen me leje të impianteve, mbikëqyrjen inspektuese, si dhe detyrimet e operatorëve, lidhur me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga veprimtaritë e ndryshme industriale, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë për mbrojtjen e mjedisit.
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i cili ka për qëllim: 1.1. të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private; 1.2. t’i përcaktojë rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private; 1.3. garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.
- Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i cili ka për qëllim t’i përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.
- Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, me të cilin rregullohet sistemi i mbrojtjes dhe i ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të saj. Ky ligj

rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht: 1.1. mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore; 1.2. përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara; 1.3. vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës; 1.4. pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre; 1.5. sigurimin e së drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendimmarrje për mbrojtjen e natyrës; 1.6. sigurimin e ushtrimit të së drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë; 1.7. parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridikë dhe fizikë në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike; 1.8. mirëmbajtjen ose mënjanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën, sipas standardeve të BE-së; 1.9. ruajtjen e të gjithë llojeve të zogjve, të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

- Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, i cili ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës, si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës specifikon se resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës, që ruhen e mbrohen me ligj. Qëllimi i këtij ligji është: 2.1. të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës; [...] 2.3. të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi; [...].
- Ligji nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësi Publike, në nenin 6 definon se shëndetësia publike është: disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, dhe në paragrafin 6.1 përcakton se IKShPK-ja hulumton ndikimin e faktorëve mjedisorë në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet.
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i ka saktësuar detyrat e komunës për mbrojtjen e mjedisit brenda territorit të vet, i cili në nenin 17 përcakton se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, “*planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e mjedisit lokal,.... mbrojtjes së të drejtave të njeriut, [...]* shëndetësinë publike.”
- Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore definon se objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të krijuara gjatë shekujve, andaj vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me

ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

48. Avokati i Popullit sjell në vëmendje se zbatimi i ligjeve, përveçse është i karakterit obligues, është një element kyç i sistemit juridik dhe i funksionimit të shoqërisë në përgjithësi. Zbatimi efektiv i ligjeve është i rëndësishëm për të siguruar që një shoqëri funksionon në mënyrë të rregullt, të drejtë dhe të barabartë dhe ndihmon në krijimin e një baze të qëndrueshme për jetën shoqërore dhe promovimin e vlerave të drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të individëve.
49. Deklarata e Stokholmit, e vitit 1972, na sjell në vëmendje një parim të fuqishëm, i cili shpalos bazën e së drejtës për të jetuar me dinjitet dhe mirëqenie dhe të cilin do të duhej ta kishim parim pikësynimi gjithsecili nga ne: (Parimi 1) *“Njeriu ka të drejtën themelore për liri, barazi dhe kushte të përshatshme të jetës, në një mjedis të një cilësie që lejon një jetë me dinjitet dhe mirëqenie, dhe ai mban një përgjegjësi solemne për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.”*
50. Parimisht, e drejta ndërkombëtare mjedisore synon të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm që do të thotë zhvillim që u lejon njerëzve të kenë një cilësi të lartë jetese të tanishme pa sakrifikuar cilësinë e jetës së brezave të ardhshëm.

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së lidhur me mjedisin jetësor

51. Avokati i Popullit, duke u bazuar në nenin 53 [*Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut*] të Kushtetutës, sipas të cilit, të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vazhdim sjell në vëmendje disa raste të rëndësishme të vendosura sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, përkitazi me mjedisin jetësor.
52. Në rastin *Pavlov dhe të tjerët kundër Ruisë* (2022), gjykata argumenton se edhe pse aplikuesit në Pavlov jetonin në distanca të konsiderueshme nga vendet ndotëse dhe nuk kishin ofruar prova që tregonin një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e tyre, shumica e gjyqtarëve ishin të kënaqur duke vërejtur se “nivelet e ndotjes [...] nuk ishin të papërfillshme” (paragrafi 71) dhe jashtë niveleve të ndotjes që priten në përgjithësi nga “jeta në çdo qytet modern”. Distanca e konsiderueshme nga fabrika nuk e pengoi gjykatën të vlerësonte nëse ndërhyrja kishte qenë e justifikuar apo jo, në vend që të kishte refuzuar të shqyrtonte rastin për shkak të distancës së vendit ndotës.
53. Ndikimi i ndotjes së mjedisit në mirëqenien e qytetarëve po ashtu pasqyrohet edhe në rastin e GjEDNj-së, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë* (1998), në të cilin gjykata kishte vlerësuar se ndotja e mjedisit mund të ndikonte negativisht në mirëqenien e individëve dhe në gëzimin e shtëpisë, respektivisht në jetën private dhe familjare, duke theksuar se shteti nuk e kishte përmbushur detyrimin e tij pozitiv për ta siguruar të drejtën e ankuesve për të respektuar jetën e tyre private dhe familjare, që bie në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës. Në këtë rast gjykata po ashtu argumentonte të drejtën e qytetarëve për t’u informuar mbi rreziqet mjedisore. Gjykata shtjellonte se *aplikuesit priten deri në përfundimin e prodhimit të plehrave në vitin 1994, për informacion thelbësor që do t’u mundësonte të vlerësonin rreziqet që ata dhe familjet e tyre mund të përballonin nëse do të vazhdonin të jetonin në Manfredonia, një qytet veçanërisht i ekspozuar ndaj rrezikut në rast aksidenti në fabrikë.*

54. Në rastin *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës (2004)*, gjykata e shtjellon konceptin “viktimë”, i cili korrespondon me lidhjen ndërmjet aplikuesve dhe dëmit të shkaktuar. Sipas gjykatës, në mënyrë që një aplikues të mundë të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të Konventës, duhet të ketë një lidhje mjaftueshëm të drejtpërdrejtë midis aplikuesit dhe dëmit që ai konsideron se ka pësuar për shkak të shkeljes së pretenduar.
55. Në rastet *Boudayeva dhe të tjerët kundër Ruisë (2008)* dhe *Kolyadenko dhe të tjerët kundër Ruisë (2012)*, gjykata, lidhur me rastet e ndikimeve të mundshme të dëmeve mjedisore në të drejtat e qytetarëve, kishte theksuar obligimin e shtetit për “miratimin e një kuadri rregullator për veprimtari që mund t’i cenojnë të drejtat themelore për shkak të dëmtimit të mjedisit”. Ndërsa në rastin *Öneryıldız kundër Turqisë (2004)*, gjykata kishte trajtuar obligimin e marrjes së masave operationale nga shteti kur dihej ose duhej ta dinin ekzistencën e një rreziku të tillë.
56. Në rastin *Moreno Gómez kundër Spanjës (2005)*, gjykata argumentonte se ndotja mjedisore, përkatësisht dëmet materiale të paprekshme, mund t’ia privonin një personi të drejtën për gëzimin e shtëpisë së tij (neni 8 i KEDNj): “[Shtëpia] konceptohet jo vetëm si e drejta për një hapësirë të thjeshtë fizike, por edhe si ajo e gëzimit, në qetësi të plotë të hapësirës në fjalë. Shkeljet e së drejtës për gëzimin e shtëpisë nuk mbulojnë vetëm dëmtimet materiale apo trupore por mbulojnë edhe dëmet jomateriale ose të paprekshme, të tilla si zhurma, emetimet, erërat e këqia dhe ndërhyrje të tjera.” Po ashtu në rastin *Lopez Ostra kundër Spanjës (1994)*, (aktgjykimi *mutatis mutandis*), gjykata kishte konstatuar: “[...] dëmtimi serioz i mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e personave dhe t’i privojë ata nga gëzimi i shtëpisë së tyre në mënyrë të tillë që të dëmtojë jetën e tyre private dhe familjare pa rrezikuar seriozisht shëndetin.”
57. Në rastin *Băcilă kundër Rumanisë (2010)*, gjykata kishte shtjelluar si vijon: “Interesat ekonomike nuk mund të tejkalojnë të drejtën e personave në fjalë për të gëzuar një mjedis të ekuilibruar dhe të shëndetshëm. Ekzistenca e pasojave të rënda dhe të vërtetuara për shëndetin e popullatës përbën një detyrim pozitiv për shtetin për të miratuar dhe zbatuar masat e arsyeshme dhe adekuate të afta për të mbrojtur mirëqenien e tyre.”
58. Në rastet *Depalle kundër Francës (2010)*; *Hamer kundër Belgjikës (2007)*; *O’Sullivan kundër Irlandës (2018)*; *Matos e Silva, Lda & al. kundër Portugalisë (1996)*; *Valico S.R.L. kundër Italisë (2006)*, përkitazi me të drejtën e pronës dhe të mjedisit, gjykata kishte theksuar si vijon: “Duhet të arrihet « ekuilibri i drejtë » ndërmjet interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtat themelore të individit një proporcion të arsyeshëm ndërmjet mjetit dhe qëllimit. Në shoqëritë e sotme, mbrojtja e mjedisit është një konsideratë gjithnjë e më e rëndësishme - nuk i nënshtrohet të drejtave themelore, siç është e drejta e pronës.” Në lidhje me rrethanat e ngjashme, duhet pasur parasysh ekuilibrin e drejtë që duhet vendosur ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe të komunitetit në tërësi, dhe në çdo rast shteti gëzon një kufi të caktuar vlerësimi.

E drejta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

59. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është një koncept i cili përfshin rritjen ekonomike, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit. Qëllimi është të sigurohet një zhvillim që mund të qëndrojë në kohë, duke mos i rënë barrë mjedisit dhe duke mbështetur nevojat e

brezave të tanishëm pa e vënë në kompromis aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Rritja ekonomike e qëndrueshme është padyshim e nevojshme, por e njëjta duhet të realizohet me efektin sa më të vogël të mundshëm në ndotjen e mjedisit dhe pa efekte negative në shëndetin e njeriut, duke përdorur inovacionin dhe teknologjinë e pastër. Standardet e zhvilluara ndërkombëtare proklamojnë se një ekonomi e të drejtave të njeriut është çelësi i zhvillimit të qëndrueshëm.

60. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kapitullin IX [Marrëdhëniet Ekonomike], Neni 119 [Parimet e Përgjithshme] në paragrafin 4 garanton se *Republika e Kosovës* promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Ndërsa kompetencë kushtetuese për Qeverinë e Republikës së Kosovës është të mundësojë zhvillimin ekonomik të vendit (neni 93, paragrafi 2).
61. Agjenda 2030, Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 9 [Industri, novacion dhe infrastrukturë në qëllimin], në Qëllimin 9.2 i jep rëndësi të theksuar nevojës për zhvillim ekonomik industrial, e cila shprehimisht përcakton si vijon: *“Të promovohet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa e industrisë në punësim dhe në prodhimin e brendshëm bruto, në përputhje me rrethanat kombëtare, dhe të dyfishohet prania saj në vendet më pak të zhvilluara.”*
62. Avokati i Popullit rikujton se qëllimi legjitim i shtetit për zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit jetësor është të arrijë një ekuilibër të qëndrueshëm midis përparimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit të natyrshëm. Ky ekuilibër thekson rëndësinë e promovimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale të popullsisë pa dëmtuar mjedisin dhe burimet natyrore, të cilat janë të nevojshme për jetesën.
63. Rëndësinë e gjetjes së një ekuilibri proporcional dhe të përshtatshëm midis qëllimeve të ndryshme të zhvillimit ekonomik, në rrethana kur një qëllim mund të ndikojë në të drejta ose në interesa të tjera, përfshirë mjedisin jetësor, duhet të aplikohet principi i proporcionalitetit në mënyrë që të sigurohet një balancim mes qëllimeve të zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit.
64. Rrjedhimisht është e qenësishme se për përmbushjen e një të drejte edhe nëse lidhet me mirëqenien e njeriut, nuk duhet të afektohet privimi nga një e drejtë tjetër po aq e rëndësishme për mirëqenien dhe shëndetin e njeriut. Andaj është detyrim pozitiv i shtetit që të sigurojë se në hapat e zhvillimit ekonomik të vendit të kujdeset në përpikëri për minimizimin e çdo dëmi të mundshëm në mjedis dhe të analizojë, me ndihmën e ekspertizës së posaçme, çdo efekt negativ që mund të ndikojë në shëndetin e njeriut. Në rastin *Băcilă kundër Rumanisë, 2010*, GjEDNj-ja kishte theksuar: *“Interesat ekonomike nuk mund të tejkalojnë të drejtën e personave në fjalë për të gëzuar një mjedis të ekuilibruar dhe të shëndetshëm. Ekzistenca e pasojave të rënda dhe të vërtetuara për shëndetin e popullatës përbën një detyrim pozitiv për shtetin për të miratuar dhe zbatuar masat e arsyeshme dhe adekuate të afta për të mbrojtur mirëqenien e tyre.”*
65. Avokati i Popullit rikujton se për rastin konkret autoritetet publike, të veshura ligjërisht me përgjegjësi, të cilat duhet të vendosin për çështje të ndërlikuara të politikave për mjedis dhe ekonomi, domosdoshmërisht procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë studime dhe hulumtime të mirëfillta, në mënyrë që paraprakisht t'i parashikojnë dhe

vlerësojnë efektet dhe pasojat e atyre veprimeve që mund ta dëmtojnë mjedisin dhe t'i cenojnë të drejtat e njeriut.

66. Autoritetet publike, në rastet e ndërlikuara në të cilat mund të ndeshen të drejtat themelore të njeriut, duhet të vendosin një ekuilibër ndërmjet interesave të ndryshme kundërthënëse dhe të sigurohen që të veprojnë, kur është e domosdoshme, që ndikimi në cenimin e të drejtave të jetë në shkallën më të ulët të mundshme. Po ashtu niveli i rëndësisë për informimin e qytetarëve lidhur me veprimet konkrete dhe me informatat e hollësishme mbi nivelin e ndikimit në të drejtat e tyre është i qenësishëm.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

67. Avokati i Popullit, në rastin konkret, bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë opinion, si dhe analizimit të standardeve ligjore vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton si vijon:
- a) Në lidhje me të drejtën e qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje, është evidentuar mungesë e informimit efektiv për mbajtjen e debatit publik. Qytetarëve nuk u është ofruar një qasje e përshtatshme në informacion për qëllimin dhe kohën e debatit publik, dhe për pasojë jo të gjithë qytetarëve të interesuar u është krijuar mundësia të merrnin pjesë në debatin publik. Në mënyrë që kjo e drejtë e garantuar të marrë karakterin e zbatimit efektiv, shteti duhet t'u mundësojë qytetarëve jo vetëm pjesëmarrjen, por edhe mundësinë që ata të ndikojnë dhe të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes.
 - b) Avokati i Popullit konsideron se banorëve nuk u është ofruar informacion konkret dhe i detajuar për gjithë procesin e iniciuar, përfshirë procedurat zyrtare, veprimet dhe hapat konkretë lidhur me projektin e ndërtimit të fabrikës së çimentos. Obligimi ligjor i autoriteteve shtetërore, qendrore dhe lokale, është se ato duhet të jenë mjaftueshëm transparente në lidhje me projektet dhe proceset e zhvillimeve ekonomike, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë mundësinë t'i monitorojnë zhvillimet. Kjo praktikë forcon bindjen e qytetarëve në institucionet e qeverisjes dhe ndihmon në ndërtimin e një shoqërie më të përfshirë dhe të informuar.
 - c) Duke marrë parasysh se zhvillimet ekonomike në fushën e industrisë minerale, si në këtë rast projekti për ndërtimin e fabrikës së çimentos, është konstatuar se autoritetet kompetente nuk kanë ofruar një hulumtim të mirëfilltë për vlerësimin dhe parashikimin e ndikimeve negative në mjedis. Një studim dhe hulumtim është i domosdoshëm për të ofruar informacion konkret mbi nivelin e ndikimit negativ të mundshëm në mjedis në të gjithë komponentët, si ndikimi në aspektin e dëmeve materiale, po ashtu edhe në aspektin e dëmeve jomateriale, ose të paprekshme, si p.sh.: cilësia e ajrit, niveli i zhurmës etj.
 - d) Duke qenë se në rastin konkret aktivizohen e drejta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, Avokati i Popullit vlerëson se nuk është ofruar një studim profesional i proporcionalitetit për të arritur deri te ruajtja e balancës midis këtyre dy aspekteve. Përderisa zhvillimi ekonomik siguron rritje të ekonomisë, punësim, dhe përparim shoqëror, ndërthurja e tij me ndikimin mbi mjedisin mund të ketë pasojat negative të paqëndrueshme. Andaj shteti duhet të sigurojë që në rastet e ndërlikuara në të cilat mund të ndeshen të drejtat themelore të njeriut, ndikimi në cenimin e të drejtave të jetë në shkallën më të ulët të mundshme.

e) Mospërgjegjja e MMPHI-së në shkresat e Avokatit të Popullit, nëpërmjet të cilave ka kërkuar informacion për veprimet e ndërmarra lidhur me këtë rast, konsiderohet si pengesë në punën e Avokatit të Popullit në analizimin dhe vlerësimin racional të rastit në aspektin e të drejtave të njeriut. Mosbashkëpunimi me Avokatin e Popullit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 132, paragrafi 3, shprehimisht përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.”*

Andaj Avokati i Popullit, bazuar në të gjeturat e renditura më lart, vlerëson se shteti duhet ta ketë parasysh ruajtjen e vlerave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ruajtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj, ruajtjen e burimeve ujore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e florës dhe faunës, në mënyrë që të gjitha vendimet për proceset e zhvillimit ekonomik, të cilat mund t’i prekin këto dukuri natyrore, të jenë të qasshme për qytetarët e interesuar, të merren me shumë seriozitet, analizim dhe vlerësim të detajuar paraprak, në atë mënyrë që ndikimi negativ në pengimin e gëzimit të të drejtave të njeriut të jetë sa më i vogël i mundshëm, dhe në atë mënyrë që qytetarët të mos ndihen të rrezikuar për gëzimin e jetës dhe të shtëpisë së tyre në të ardhmen nga zhvillimet e industrisë minerale, nën hijen e territ informativ.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës mbajtur me datë 20. 09. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje; Kryetari i Komunës z. Zenun Elezaj, nënkryetarja znj. Marqe Selmanaj, drejtorët e drejtorive, Komandanti i policisë në Klinë, OSBE, media lokale, anëtarët e kuvendit, qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti gjithë të pranishmit.

Kryesuesi tha se prezent janë 22 anëtarë të kuvendit.

Për Rendin e ditës fjalën e kërkuar:

z. Esat Raci: Përshëndetje. Dua ta konfirmoj që dy anëtarëve të kuvendit nga PDK nuk ju ka ardhur materiali.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje. Materialin nuk e kam pranuar as për seancën e kaluar dhe as për këtë seancë. Jam konsultuar me IT e komunës dhe e kam parë që ai ju ka dërguar email në Prishtinë por nuk i kanë kthyer përgjigje. Tani në mungesë të materialit unë s` di si të veprojmë e as çka të them.

z. Fadil Gashi, kryesues: Pajtohem me vërejtjet e juaja por nuk pajtohem me neglizhencën e nivelit qendror që nuk intervenojnë në rregullimin e këtij problemi derisa nuk është në dorë të IT së Komunës.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Kërkoj që në emër të grupit tonë kuvendar që miratimi i buxhetit të zhvendoset në pikën e tretë të rendit të ditës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kemi një kërkesë për zëvendësim të pikës së rendit të ditës

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Është e vërtetë që ka probleme me materialin që na vjen. Ai material vjen i përgjysmuar. Ajo që unë kërkoj nga grupet opozitare që ne sot të reflektojmë në lidhje me këtë pasi që kryetari i komunës nuk është në nivelin e përgjegjësisë dhe nuk na ofron atë që e thotë vet. Në muajin e gjashtë Zenun Elezaj e thotë që operatori për të cilin ka pyetur Zaferi duhet të gjendet emri dhe të ju dërgohet të gjithë anëtarëve. I drejtohet drejtorit të inspektoratit që menjëherë të veprojmë. Ju lutem mos premtoni. Materiali për atë që e thash është premtuar që dy mbledhje dhe nuk ka ardhur.

z. Fadil Gashi, kryesues: Është një çështje që dua të jua them. Është edhe një seperacion i ri që ka filluar aty në atë pjesë. Inspektorati i ka inspektuar të gjitha. Është duke u përgatit edhe lënda. OE që ke kërkuar ti Zafer ka dalë me gjithë dokumentacionin në rregull. Një regjistër tjetër kemi kërkuar për uzurpimet në zonën urbane. Drejtoria e ka nisë punën për tërë territorin e Klinës. Një informacion tjetër i mirë është se kemi mbërritur një dakordancë me MAPL dhe atë të financave që të bëhen pagesat nga mallrat dhe shërbimet për komitetet dhe organet e formuara të kuvendit.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Në seancën e kaluar jemi dakorduar që ta zhvendosim pikën Pyetje dhe Përgjigje në radhën në pikën e tretë. Unë dëshiroj që t` jua bëjë me dije se çfarë thotë ligji për vetëqeverisje lokale për detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit. Ky ligj thotë që anëtarët e kuvendit janë të obliguar që të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit përveç rasteve kur ekziston arsye e justifikuar për mungesën e tyre. Neve shpesh po na ndodhë që ta ,mbyllim mbledhjen me 15 e 16 anëtarë e që kjo është mos respekt në radhë të parë për Kuvendin e Komunës. Unë ju bëjë thirrje të gjithë anëtarëve që të marrin pjesë deri në fund të mbledhjes dhe mos ta braktisin atë.

Kryesuesi tha se sa i përket mungesës së materialit, anëtarët e kuvendit mund të kërkojnë që materiali të ju bëhet edhe kopje fizike.

z. Esat Raci: Me gjithë respektin për propozimin e Arben Limanajt, unë kërkoj që këto dy [pika të më hershme të kalohen më shpejtë dhe të vijmë më shpejt tek miratimi i buxhetit.

Rendi i Ditës me 20 vota për asnjë kundër dhe dy abstenime u MIRATUA

Pika 1 e rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

- **Prezent janë 22 anëtarë të kuvendit**

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

- **Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Pika 3 e Rendit të Ditës”: Pyetje dhe Përgjigje

z. Esat Raci: Kam dy tre pyetje [për ekzekutivin. Për kryetarin e Komunës: Do të doja që ta bëje transparente letrën e avokatit të popullit të datës 2. 9. 2024, opinionin e avokatit të popullit për fabrikën e çimentos. Këtë ta bësh ose sot ose në seancën e radhës ta kemi komplet të shkruar opinionin e tij. Pyetja e dytë: Pse shujtat e punëtorëve publik disa i kanë marrë e disa jo, i kanë marrë punëtorët e zyrës së kryetarit dhe disa të tjerë e shumica jo, pse bëhen kështu në mënyrë selektive. Pyetja tjetër për drejtorin e arsimit: Kam disa ankesa nga prindërit për fëmijët e tyre në klasën e parë. Disa mësimdhënësë janë në pushimin e lehonisë dhe prindërit thonë se nga dy mësimdhënës i kanë ndrru edhe pse vetëm pak kohë ka që ka filluar procesi mësimor.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Përshëndetje. Raportin e avokatit të popullit nuk e kam analizuar por e di që ka ardhur. Nëse është e lejueshme do të jua dërgoj por edhe jam në gjendje që në seancën e ardhshme dal dhe e lexoj. Besoj që do të jua dërgojmë të gjithëve. Sa i përket

shujtave për shërbyesit civil nuk kam asnjë ndikim. Është vendim i gjykatës së apelit. Ne i kemi dërguar tre herë që të bëhen pagesat por thesari nuk i ka bërë pagesat.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve. Është e vërtetë që kemi pasur probleme sa i përket mësimdhënësve pasi që ne më kohë i kemi pasur të përgatitur konkurset por në gjysmë të Gushtit kanë ndryshuar rregullorja dhe na kanë ndaluar që të shpallim konkurs me rregulloren e vjetër. Tani kjo ka kaluar tek zyra e personelit dhe gjithçka është në rregull.

z. Valmir Bacaj: Kam një kërkesë për kryetarin e Komunës që në seancën e ardhshme të ndryshohen dy vendime. Vendimi i parë ka të bëjë me procedurat e kompensimit të varrimit, kërkojmë që të rritet nga 170 euro në 230 euro si dhe vendimi tjetër që ka të bëjë me ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur që shuma të rritet afërsisht për 30%. Konkretisht për fëmijën e parë nga 180 euro në 240 euro, për fëmijën e dytë nga 200 euro të bëhet 260 euro dhe për fëmijën e tretë, të katërt e kështu me radhë nga 250 euro të bëhet 330 euro. Afërsisht i kemi 460 lindje në vit dhe kosto do të ishte 30 mijë euro. Burimet i kam marrë nga enti statistikës së Kosovës.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Subvencionet janë rritur në vlerë të konsiderueshme e shihni edhe në draft buxhetin që e keni edhe kjo vlerë është përfshirë. Sidoqoftë i bisedojmë me shefat e grupeve dhe marrim vendim.

z. Kushtrim Haliti: Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizimit. Kur përfundon rruga në lagjen Bullaku në Jashanicë që ka nisur në qershor por ende nuk ka përfunduar. Dhe pyetja e dytë për drejtorin e inspektoratit që nuk është këtu: Tek banesa përball Morenës janë vendosur disa pengesa dhe e kanë vështirësuar qarkullimin e makinave. Pyetje tjetër për drejtorin e inspektorëve: A kanë inspektuar ndonjëherë në Gjurgjevik të Madh peshën e kamionëve që qarkullojnë në atë rrugë pasi që e aknë dëmtuar shumë rrugën dhe mbi të gjitha po rrezikojnë jetën e fëmijëve nxënës.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket pyetjes, mund të them se projekti është duke u ekzekutuar e i cili është dy vjeçar. Ato pjesë që kanë filluar të shtrohen me zhavorr do të përfundojnë këtë vit. Edhe lagja Bullakve është në këtë agjendë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Për vendosjen e pengesave është kërkesë e kompanisë Ambienti dhe mendoj që është pozitive pasi që vet pronari i dyqanit aty e parkon veturën e vet në rrugë, por nëse vërtetë është pengesë mund ta diskutojmë.

z. Enver Gashi: Përshëndetje: Kemi një pyetje për drejtorin e bujqësisë. Shumë fermer pyesin pse nuk janë pajisur me sera pasi që e kanë fituar subvencionin dhe deri kur duhet të presin.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Përshëndetje. Ai është projekt dy vjeçar dhe tani janë në përfund ku besoj që tre katër sera kanë mbetur pa u vendosur me kërkesën e vet fermerëve. Besoj që për dy ditë ose tre ditë do të përfundojnë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Unë pajtohem me Valmir Bacajn dhe propozimin e tij por propozoj gjithashtu që fëmija i katërt të kompensohet me 1000 euro.

Znj. Arta Pantina: Përshëndetje të gjithëve. Dua të i drejtohem drejtorit të shëndetësisë. Ka një ankesë për këtë shërbim, unë vet kam pas nevojë që të marr shërbimin shëndetësor në QKMF me 31 korrik. Kam pritur 40 minuta që të marr një infuzion duke pritur ndërrimin e pas ditës i cili ka zgjatë 40 minuta. Mendoj që është pa përgjegjësi që ky ndërrim të zgjatë 40 minuta duke lënë pacientin në pritje. Kërkesë tjetër imja e që është hera e tretë që e bëjë, është që të bëhet pastrimi i rrugëve “Mustafë Pantina” dhe “Ahmet Pantina” pasi që ka rrezik që fëmijët të aksidentohen ngase ato janë mbushur me barishte.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Përshëndetje. Fluksi i madh i pacientëve bënë që pacientët të presin. Është e pamundur që të i vendoset pacientit infuzioni dhe të bëhet ndërrimi pasi që duhet përcjellë pacienti. Sidoqoftë nëse ka pasur ikje nga përgjegjësia do të merren masa.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përshëndetje. Sa i përket rrugëve që znj. Pantina i përmendi, unë i kam parë ato rrugë dhe edhe pse kemi pak problem me mungesën e stafit do të bëjmë përpjekje që të i pastrojmë.

Znj. Blerina Berisha: Përshëndetje. A mundem ta dijë arsyen pse nuk është bërë instalimi i ndriçimit në Qupevë të epërme. Mendoj që kur të nisni instalimin e ndriçimit në një fshat ta kryeni e jo të lihet pjesë pjesë. Nuk kam asgjë kundër për pjesën që është ndriçuar por dua ta dijë kur do të bëhet ndriçimi komplet.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: NË Qupevë të lartë kemi qenë bashkë me kryesuesin dhe e dij që 90% e fshatit është kryer. Çdo mangësi sa i përket ndriçimit do ta kompletojmë. Edhe në Çabiq vjet pat mbetur një pjesë e vogël por që e kemi kryer këtë vit. Bazuar në buxhetin që kemi bëjmë edhe instalimet fazë fazë.

z. Zafer Gashi: Unë do ta lus kryetarin që të më përgjigjet e mos të ma gjuajë pyetjen tek drejtorët pasi që po i përdor edhe për kërcënime. Tani që do të filloj fushata a do të filloni me ndërtimin e trotuarit në tërë fshatin. Prap po e përsëris a do të aplikoni në ministrinë e infrastrukturë për banesë sociale. E fundit, Kryetar unë gabimisht ju kam marrë në telefon duke menduar që po e thërras drejtorin Millaku. Kam bërë kërkesë tek z. Millaku i cili shumë korrekt më ka udhëzuar se në cilën drejtori ta bëjë kërkesën e të cilën më pastaj e kam bërë tek z. Berisha dhe ai... shikoni, kryetar kur kam thënë unë këtu që ju jeni fatkeqësia e zgjedhjes së qytetarëve po ju them mos e qoni gjendjen në tragjedi sepse je duke rrezikuar familjen time. Vendimin që keni lëshuar a e ke lëshuar ti, a e dini çfarë dualizmi keni krijuar dhe keni shkaktuar kërcënim. Unë dhe fqinji im kemi pasur probleme dhe rasti është në polici. Si keni pasur të drejt të lëshoni vendim për rrugën që unë e posedoj me vendim gjyqësor , me kadastër etj. që nga viti 2006.

Kryesuesi ndërhyne duke e orientuar në pyetje z. Gashi. Z. Zafer Gashi vazhdon:

“Është bërë falsifikim i dokumenteve zyrtare nga drejtori Enver Berisha. Në një vend thotë që për ndërtimin e kërkuar nuk kërkohet leje dhe i referohet një udhëzimi administrativ të

ministrisë së ambientit, më [poshtë e shpik një lloj fjalë ku thotë që kjo laurë nuk mund të vendose për çfarë do pengese etj. Ju lutem kryetar mos e përdor pushtetin që ta ka dhënë qytetari që të hakmerresh ndaj meje”

z. Zenun Elezaj, kryetar: Fillimisht unë nuk e kam nënshkruar atë shkresë. Ai që e ka nënshkruar le të i rrijë karshi.

Në vazhdim është duke u diskutuar pa mikrofon dhe është e pamundur që të shkruhet procesverbal i këtij debati.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë të kam mik shpije dhe nuk kam asgjë kundër teje Zafer. E kam obligim moral që ta deklaroj para qytetarëve.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Po me çuditë niveli yt. Ky dokument e ka një emër dhe mbiemër që ka nënshkruar. Përdori të gjitha metodat juridike. E ke këshillën juridike në fund të dokumentit.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së

Kryesuesi tha se janë dy kërkesa që KPF i ka rekomanduar tek komisioni për vlerësimin e dëmeve dhe kategoria e buxhetit përveç të tjerave që janë në rend të ditës.

Me 21 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua kërkesa e parë.

Kërkesa e dytë KPF ka propozuar që të hynë në kategorinë e buxhetit në bashkëpjesëmarrje për financim. Është fjala për instalimin e një lifti.

z. Valmir Bacaj: Të kësaj natyre është edhe një kërkesë tjetër e banorëve të banesës “Mirusha” Afër shkollës “Ismet Raci” kërkoj që të shtohet edhe kjo kërkesë e të futet në buxhet.

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA edhe kërkesa e dytë.

Për mbledhjen e dytë të KPF të mbajtur me 6 shtator, kryesuesi tha se përveç atyre që janë në rend të ditës janë edhe dy kërkesa. Fjala është për një zonjë që kërkon të subvencionohet për banim. Shuma është 1000 euro.

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kërkesën e dytë e kemi orientuar tek zyra e kryetarit që të trajtohet

Me 20 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika e 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit nga dëgjimi me publikut lidhur me draft buxhetin për vitin 2025 me projeksionet për vitin 2026, 2027.

Pasi që anëtarët e kuvendit e kanë raportin dhe e kanë lexuar kalohet në pikën e radhës

Pika 6 e Rendit të Ditës; Shqyrtimi dhe miratimi i draft buxhetit për vitin 2025 dhe projeksionet për vitin 2026 dhe 2027.

z. Esat Raci: Ne si grup kuvendar i PDK-së vazhdimisht e kemi votuar buxhetin dhe e kemi thënë jo për arsye të ekzekutivit por të qytetarëve. Këtë radhë ne nuk do të marrim pjesë , po jua jap edhe arsyet. U bënë 7 vjet që ky pushtet vazhdimisht e ka premtuar ujin e pijshëm për qytetarët e komunës, ata akoma vazhdojnë të bartin ujë e të blejnë ujin e pijshëm. Ky pushtet, ky kryetar i komunës asnjë investim të madh kapital për këto 7 vite nuk e ka ndërtuar, asnjë çerdhe, asnjë palestër e qendër rinore prandaj ne nuk do ta marrim pjesë në votimin e këtij buxheti. Vazhdimisht kemi kërkuar që me ndarjen e subvencioneve në bujqësi të keni kujdes përkundër kësaj kanë vazhduar shkeljet e kriterëve gjë që edhe është e gjetur nga auditori i përgjithshëm. Për gjitha këto ne nuk do të marrim pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Për ujin e pijshëm, Esat aq keq e keni prish ju sa keni qenë në pushtet, aq keq e keni bërë atë fabrikë të ujit sa është vështirë edhe shumë vjet të ndreqet. Çerdhet i ndërton dikush tjetër...

z. Esat Raci replikon duke dalë nga salla por është pa mikrofon

Grupi i PDK-së e braktisë mbledhjen në këtë pikë të rendit të ditës, duke theksuar se në pikat e tjera të Rendit të Ditës do të marrin pjesë, përveç anëtares së grupit të PDK-së, znj. Mendehie Duraku e cila qëndron në sallë.

z. Enver Berisha, drejtor i FZHE: Të nderuar të pranishëm. Realisht për ata që dinë të vlerësojnë dhe janë në shërbim të popullit duhet ta dinë që kjo është pika më e rëndësishme që trajtohet në një vit kalendarik. Mos të jesh pjesë e këtij buxheti duke mos dhënë kërkesat dhe vlerësimet nuk është në rregull por gjithkush e ka përgjegjësinë e vet. Të nderuar asamblist sikurse edhe hera të tjera, ne duke u bazuar në ligjin për buxhetin kemi kryer obligimet tona duke dalur dhe debatuar me qytetarë për kornizën afatmesme buxhetore. Bazuar në kërkesat e qytetarëve nëpër debate për këtë qëllim ne kemi hartuar draft buxhetin për vitin 2025. Sigurisht që kemi marrë për bazë edhe në buxhetin që e ofron niveli qendror, ne i kemi diskutuar dhe jemi dakorduar që kërkesat më të rëndësishme në interes të qytetarëve pa dallim i kemi bërë pjesë të këtij buxheti. Të gjitha parametrat demokratik dhe transparent janë shfrytëzuar për hartimin e këtij draft buxheti. Dua ta përmend buxhetin e përgjithshëm në kategoritë e parapara.

Drejtori i Ekonomisë, z, Berisha në vazhdim foli për draftimin e buxhetit nëpër kategori duke e përfunduar se “ Obligimin ashtu siç duhet duke zhvilluar debate nëpër teren, duke marr sugjerime dhe kërkesat e qytetarëve e kemi kryer”.

z. Valmir Bacaj: Më gëzon fakti se buxheti është rritur për 1.5 milion më shumë. Sigurisht që nuk mund të përfshihen të gjitha kërkesat e qytetarëve pasi që qeveria e vendit e ka heq Klinën nga lista e përkrahjes. Asnjë përkrahje nuk e kemi pasur nga qeveria e as [projektet që i ka nisur nuk i ka përfunduar. Më habit fakti që grupi kuvendar i PDK-së e braktisë seancën duke u thirru në kërkesa të pa realizuara ndërsa në raportin nga procesi i dëgjimeve buxhetore asnjë kërkesë e vetme nuk është nga ta. Kërkesat e qytetarëve janë përfshi në këtë draft buxhet e që janë 66 kërkesa. Sigurisht meritë e gjithë kësaj është edhe zyra për informim , zonja Vlora Tafili.

Znj. Mendehie Duraku: Përshëndetje të gjithëve. Unë si anëtare e kuvendit nuk kam mundur të përcjell dëgjimet buxhetore për arsye familjare. Edhe pse e konsideroj që ky draft buxhet ka mangësi ashtu sikurse viteve të kaluara unë do të votoj pro.

Znj. Lirie Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Sot në shqyrtim të këtij draft buxheti kemi shumë kërkesa dhe ankesa, kështu që bashkërisht jemi këtu për ti zgjedhur dhe unë jam këtu bashkë me ju për ti adresuar çështjet dhe problemet e qytetarëve. Jam këtu sepse jam zëri i tyre dhe do të jam mbështetja e tyre gjithmonë. Ju lutem organit kompetent, çdo cent i këtij buxheti të jetë në vendin e duhur. Te ky buxhet shohim sytë e qytetarëve, është interes i të gjithëve. Në këtë material janë përfshirë të gjitha fshatrat pothuajse të gjitha por unë nuk e pashë rrugën “Heronjtë e Kombit” në Dollc nuk e pashë askund. Një kërkesë tjetër e kam për shkollën në Çabiq, rrugët në Rixhevë, Zabergjë, Ujmir janë të dëmtuara, kanë nevojë të rinovohen.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Rruga “Heronjtë e Kombit” është e përfshirë por ndoshta shkak i emërtimeve nuk janë përshkruar. Që nga viti 2025 do të fillojnë dhe janë të shpërndara investimet në vite bazuar në buxhetin që ka komuna.

Znj. Marigona Raci: Përshëndetje. Gjatë shqyrtimit të draft buxhetit kemi parë shumë [projekte që planifikohen për vitin 2025 e të cilat disa janë bartur vit pas viti. Për buxhetin që është ndarë 35000 euro për fshatin Siqevë, Shtaricë dhe Ujmir është një shumë e vogël për ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore. Në projektet për shëndetësi pse nuk janë futur edhe shpenzimet e furnizimit me barna esenciale që kanë rëndësi shumë për qytetarët e Komunës sonë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Këtë vit mendohet që të përfundojnë të gjitha rrugicat në këto fshatra. Mjetet që kemi planifikuar për vitin e ardhshëm janë investime simbolike në bazë të nevojave të vogla që do të dalin. Përndryshe me këtë buxhet që kemi paraparë nuk do të mbetet asgjë pa u kryer sa i përket infrastrukturës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Drejtorive përkatëse nga niveli qendror ndoshta veç ju ka ardhur shkresa që tek mallrat dhe shërbimet është mirë të planifikohen pagesat e trupave të kuvendit. Këtë vit është dakorduar që të merren aty ku të kemi mundësi por për vitin e ardhshëm duhet të planifikohen. Ndoshta si kuvend është mirë të epet drita jeshile që drejtoria të bëjë planifikimin e kësaj kategorie.

z. Adnan Beqiri: E shoh që ky draft buxhet është përgatitur në mënyrë profesionale dhe e shoh që ndarja uniforme duke përfshi të gjitha fshatrat dhe lokacionet nuk shohë arsye që ky buxhet të mos votohet prandaj ftoj të gjithë kolegët që të votojnë pro.

z. Fadil Gashi, kryesues: Pajtohem me gjithë që ky është buxhet i gjithë qytetarëve tanë. Është buxhet i taksapaguesve që mbushin arkën e komunës dhe ju kthehet në formë investimesh. Nuk kemi nevojë as të bëjmë lojëra as filma e as të kemi forca policore këtu. Mund të kundërshtohemi me zë të ulët por asgjë nuk duhet të del para interesit të qytetarëve. Ky mandat vitin që vjen mbaron dhe ne do të takohemi prap. Na lidhë jeta përditshmëria e do të takohemi në situata të ndryshme ku kemi me pasur nevojë për njeri tjetrin. Mos ti marrim gjërat me eufori sepse me eufori as atdheu nuk mbrohet.

Kryesuesi e vuri në votim draft buxhetin dhe me 13 vota për , 2 abstenime, asnjë kundër u MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Drejtoria e arsimit duke u bazuar në rregulloren për ndarjen e bursave ndanë për studentë të komunës së Klinës 80 bursa për këtë vit akademik. Pra, janë 20 bursa më shumë dhe ju kisha lutë që të marrë miratimin tuaj.

Znj. Lirie Gashi: Unë do të kërkoja që nga 80 të bëhen 100 bursa.

z. Armend Beqiri: E shoh që ka rritje të bursave dhe unë pajtohem me kolegen, propozimin e saj por kish me qenë mirë që kjo rritje e propozuar të bëhet vitin e ardhshëm.

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të ditës: Formimi i komisionit për ndarjen e bursave

U propozuan 1. Elbarim Morina, 2. Nikson Dakaj, 3. Arlinda Selitaj, 4. Kushtrim Haliti dhe 5. OJQ(plotësohet më vonë nga OJQ)

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA komisioni.

Pika 9 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i anulimit të vendimit të marrë me numër 06 -18355/2024

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U ANULUA

Pika 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për rialokim të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike-shpenzime kapitale.

Me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 11 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për shfuqizim të vendimit numër01-06-20948/2024

Me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U SHFUQIZUA

Pika 12 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit 01 401-28868/2024 për transferë të mjeteve

Me 18 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Konsultim Paraprak: Kjo fazë është zhvilluar gjatë periudhës së raportimit nga komunat. Në këtë fazë zyrtarët e divizionit të performancës komunale të MAPL kanë udhëzuar zyrtarët raportues për plotësim/korrigjim të të dhënave të raportuar. Përgjigjet në komentet e ministrisë janë vendosur në platformën e konsultimit dhe/ose në platformën e raportimit.

Verifikim me mostër: Pas përfundimit të procesit të raportimit nga komunat, u zhvillua një verifikim i detajuar i të dhënave për 27 treguesit e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Ky proces përfshinte analizën e dokumentacionit, të dhënave të raportuara dhe dëshmime të bashkëngjitura.

Verifikim në Terren: Për të siguruar vërtetësinë e të dhënave të raportuara dhe për të verifikuar zbatimin e tyre në terren, një ekip u angazhua për të kryer inspektimin fizik dhe monitorimin e aktiviteteve në vendet konkrete.

Rezultatet e performancës janë përfshirë në këtë raport, i cili ofron një pasqyrë të detajuar e performancës së komunave, përfshirë shënimet e konsultimit paraprak, verifikimit me mostër, verifikimit në terren dhe shqyrtimit të ankesave. Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë finale.

% E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	98.17
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	100
	1.1.3	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	100
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	100
	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	95.56
	2.1.3	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	100
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	78.82
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	76.09
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	100
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	100
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	100
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	29.09

	3.1.4	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	100
	3.1.5	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje	100
	3.1.6	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	0
	3.1.7	Funksionimi i këshillave lokal	0
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	100
	3.2.2	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	100
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	100
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	100
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	100
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	72.18
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	33.33
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	0
	3.4.2	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	66.67
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	15.53
	4.1.2	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	100
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	0
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	0
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	70.42
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	100
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	0
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	100
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.	100
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	100
	7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	100
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori	90.92
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	100
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	100
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	99.95
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	100
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	6.58
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	8.66
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	88.14
	9.3.1	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	0.56
	9.3.2	Rrugë lokale të riasfaltuara	100
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	0
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	100


	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	37.5
SHËRBIMET PUBLIKE	11.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	100
	11.1.2	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	100
	11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	83.33
	11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	98.63
	11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	92.13
MBROJTJA E MJEDISIT	12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	0
	12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	0
	12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	0
PËRFAQËSIMI GJINOR	13.1.1	Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale	89.23
	13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	50
	13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	36.36
	13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	100
	13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	0
	13.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	100
	13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	100
	13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	30.36
	13.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	100
	13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	6.97
13.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	35.23	
ARSIMI PARAUNIVERSITAR	14.1.1	Shkolla me masa të efikasitetit të energjisë	54.48
	14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	90
	14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	82.76
	14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	0
	14.3.1	Fëmijë që vijnë kopshtin - përgjithësi dhe rural	0
	14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	51.02
	14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	59.57
	14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	100
14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	96.41	
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	0
	15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	0
	15.2.2	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	0
	15.3.1	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	0
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	100

	16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	100
	16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	100
	16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	35.54



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Departamenti për Performancë dhe
Transparencë Komunale



RAPORTI I PERFORMANCËS SË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS JANAR-DHJETOR 2023



2

0

2

4

Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Drin Haraqia, Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale MAPL

Pjesa e përgjithshme hartuar nga:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;

Pjesa e veçantë nga:

Haxhi Krasniqi & Lazar Mitic

Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave:

Haxhi Krasniqi, U.D i Udhëheqësit për Performancë Komunale;MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Shqiponja Vokshi DEMOS

Saranda Husaj, DEMOS

Blerta Sejdiu – Junior Konsulente/DEMOS

Edita Azemi – Praktikante/DEMOS

Përmbajtja

HYRJE	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS.....	4
QËLLIMI.....	5
METODOLOGJIA.....	5
Kapitulli I.....	6
I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme	6
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MATJES SË PERFORMANCËS KOMUNALE.....	6
2. TRENDET E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE NDËR VITE	7
REZULTATET E VITIT 2023	8
Kapitulli II	13
II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023.....	13
1. REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE	13
Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative.....	14
Fusha 2 – Transparenca Komunale	14
Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale.....	16
Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	19
Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport.....	20
Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive.....	21
Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor	22
Fusha 8 – Hapësirat Publike	23
Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore.....	24
Fusha 10 – Transporti Publik.....	26
Fusha 11 – Shërbimet Publike.....	27
Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit	28
Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinnor	29
Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar	31
Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor	32
Fusha 16 – Zhvillimi Ekonomik Lokal	33
Konkluzione dhe rekomandime	35
Shtojcë: % e treguesve sipas fushave	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2023 prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 85 treguesve nga 93 sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm dhe pezulluar 8 prej tyre. Për vitin 2023, raporti përmbledh 26 tregues më pak se për vitin 2022, kjo për shkak të rishikimit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale i cili është bërë në vitin 2023.

Me kërkesën e zyrës së Kryeministrit dhe me aprovimin e Ministrit të MAPL-së, SMPK –së do t'i shtohet dhe një tregues që ka të bëjë me zvoglimin e Barrës Administrative në komuna. Ky tregues do të raportohet në vitin 2025.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet e vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Procesi i verifikimit të të dhënave është bërë në tri faza si në vijim:

- procesi i verifikimit peraparak i cili është bërë gjatë fazës së raportimit brenda 45 ditëve
- procesi i verifikimit të rregullt i cili sipas Dokumentit Kryesor përfshin 30% të treguesve e që gjithsej në këtë verifikim janë përfshirë 27 tregues në 12 komuna.
- procesi i verifikimit në teren në të cilin janë përfshirë 11 komuna me 5 tregues

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2023 kanë raportuar 34 komuna të Republikës së Kosovës¹.

Baza juridike për raportin e performancës

Matja e performancës komunale tashmë është ngritur në nivel të rregullimit ligjor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 12.08.2022. Në vitin

¹ Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Novobërdës, Zubin Poptokut, Leposaviqit, Zveqanit

2023, ka hyrë në fuqi Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e grantit për performancë komunale.

Sipas nenit 19, të ligjit procesi i matjes së performances organizohet në baza të rregullta vjetore nga Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal. Në nenin 19 të Ligjit për SMPK dhe GPK, është i përcaktuar afati i raportimit të të dhënave komunale në SEMPK.

Për më saktë, *“Procedurat dhe afatet tjera për matjen e performancës dhe vlerësimin për grant përfundojnë në pajtim me rregullat juridike që janë përcaktura me Udhëzim Administrativ.*

Referuar Ligjit Nr. 08/l-103, SMPK është i ndërtuar mbi bazën e parimeve themelore siç janë: Ligjshmërisë; Transparencës; Subsidiaritetit, meritës; objektivitetit dhe paanshmërsisë; Barazisë dhe mosdiskriminimit;

Udhëzimi përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimin të performancës së komunave. Udhëzimi përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunave brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funkcionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
3. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
4. Mbrenda afatit për raportim është bërë verifikimin paraprak i të dhënave;
5. Adresimi i ndryshimeve eventuale në sistem, pas verifikimit paraprak;
6. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
7. Verifikimin e rregullt sipas mostres prej 27 treguesve
8. Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
9. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
10. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Verifikimi i të dhënave – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Kapitulli I

I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme

1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancës dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2023 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore². Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe në vitin 2023 procesi i matjes së performancës komunale është bërë me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2023, kërkesës për raportim të performancës janë përgjigjur 34 komuna, nëdërsa 4 komuna tjera nuk i kanë raportuar të dhënat në SMPK. Komuna e Novobërdes ka raportuar vetëm 31% të të dhënave. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 57.06% deri në 59.38%, në vitin 2022, kurse në vitin 2023 është 58.24%.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit dhe zvoglimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rritje po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2023, si në vijim:




Fig.1. Performanca e komunave sipas viteve 2020-2023

² Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale

Rezultatet e vitit 2023

Sa i përket të dhënave për vitin 2023, performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 85, nga gjithsej 93 tregues të matjes është 58.24%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime më të ulëta se në vitin 2022, për 1.14%, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2023 prej 1.18%.

Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (39.66%), infrastrukturë rrugore (42.45%), transport publik (46.93%), arsim parauniversitar (48.78%) barazia në punësim (49.71%) hapsia publike (51.59%), mbrojtja e mjedisit (52.56%), zhvillim ekonomik lokal (56.75%), dhe shërbime publike (58.05%), i cili shërbim është shumë afër me mesatarën e vendit.

Mbi nivelin mesatar të vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej 80.00% në nivel vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale 73.02%, menaxhimi i fatëkeqësive me (69.30%) fusha kujdesi primar shëndetësore me 68.61% pasuar nga planifikimi hapsinor me 67.90%, fusha përgjegjëshmëria komunale ka vlerën 63.79% dhe Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë shumë afër meastares së vendit ku janë ofruar në nivel të kënaqëshmëm që shprehur në përqindje janë 62.70%. Në grafikun Nr.2 shihet se 7 fusha të shërbimeve janë ofruar mbi mesatarën e vendit, ndërsa 9 fusha tjera janë ofruar nënë mesatarën e vendit që shprehur në % 43.75% të fushave janë mbi mesatare dhe 56.25% të fushave janë nënë mesatare.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 16 fushave të matjes:




Fig.2. Performanca sipas fushave

Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës, në kater nivele i kemi ndarë 16 fushat e qeverisjes nga komunat. Sipas grafikut më lartë, në nivel të lartë të performancës janë pesë (2) fusha të radhitura sipas përqindjes, shërbimet Transparenca komunale dhe 73.02%, përkthësisht 80.00% shërbimet publike administrative.




Fig. 3 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Ndërsa niveli i dytë përcatkohe sipas përqindjes e që fillon 62.70% deri në 69.30%, sikurse niveli i tretë sipas kategorisë përbën përqindjen 51.59% deri në 58.05% dhe niveli i katër ose i fundit sipas përqindjes fillon në 49.71 deri në 39.66%, sa ka edhe fuisha përfaqësimi gjinor. Nga kjo renditje shihet që nuk ka ndryshime të theksuara nga viti 2022, edhe pse në vitin 2023 është rishikuar SMPK, edhe në vitin 2022 kanë qenë të renditura njësoj sipas performancës komunale, vetëm se vërhet një ndryshim i vogël specifik sipas përqindjes.

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike

Nga figura 4 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e **Përfaqësimi gjinor**, prej 39.66.% që mund të quhet një arritje mjaft e konsiderueshme e komunave për vitin 2023. Në kuadër të fushës barazia në punësim, shërbime sociale dhe familjare niveli i përgjithshëm i arritjes shprehet me 49.71%³.

1) Standardet e qeverisjes së mirë

Në kuadër të **Shërbimeve publike administrative**, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 80.00%, Fusha Zhvillimi Ekonomik Lokal ka një nivel mjaft të lartë që shprehet me 56.75% ku edhe kjo fushë krahasuar me vitin 2022 ka një ngritje të kënaqëshme prej 23.62%. Fusha **Transparenca komunale** për vitin 2023, shprehet me 73.02% në vitin 2023. Në fushën përfaqësimi gjinor për vitin 2023, mund shihet në figurën Nr 4, dhe ka vlerën 39.66%

³ Per me teper: <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>, fq. 62




Fig. 4 % e arritur në fushat e qeverisjes

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e përgjegjshmërisë komunale, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Në vitin 2023 këto dy fusha kanë shënuar rënje, ndoshta për faktin se në vitin 2023 është bërë rishikimin i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe si rrjedhojë janë hequr disa tregues të këtyre fushave. Kjo mund të themi që është një indikacion i rënjes së ofrimit të shërbimeve tek këto dy fusha.

Në kuadër të veprimeve që **ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal** komunat kanë performancë me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 56.75%, edhe kjo fushë ka nivel të njëjet të aritjes së performancës krahasuar me vitin 2022.

Shërbime Publike- Në kuadër të kësaj fushe përfshihen tregues dhe të dhëna për ujë të pijshëm, menaxhim të mbeturianve dhe kanlizimet. Rezultatet e kësaj fushe shprehur në përqindje janë të kënaqëshme dhe kanë vlerën prej 58.05%

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 49.71%, krahasuar me 60.30% në vitin paraprak.

2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: Shërbime publike, mbrojtje të mjedisit, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjzim të rrugëve etj.




Fig.5. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2023

Fusha, **Kulturë, rini dhe sport**, për vitin **2023** ka shkallën më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi në nivel të gjitha komunave, e shprehur në përqindje në vlerën prej 62.70%, e pasuar nga sikurse edhe fusha e **Arsimit parauniversitar** si kompetencë vetanake komunale ka një renditje të mirë sa i përket ofrimit të rezultateve në ofrim të shërbimeve komunale me 48.78%. **Planifikimi Hapsinor**, renditet e katërta sa i përket listës së ofrimit të shërbimeve kualitative e cila është shprehur %, kap vlerën 67.90%, dallim të vogël vërejmë edhe në fushën **Infrastruktura rrugore**, e cila në përqindje ka vlerën prej 42.45%, me pas renditet fusha **Menaxhimi i fatkeqësive**, e cila është shprehur në përqindje në vlerën prej 69.30%. **Mbrojtja e mjedisit** ka nivel mesatar të ofrimit për të gjitha komunat dhe kap vlerën prej 52.26%, e pasuar nga fusha e **Kujdesit parësor shëndetësor**, e cila në përqindje ka vlerën prej 68.61%.

Në nivel pak më të ulët është fusha si në vijim, duke filluar nga fusha **Hapsirat Publike**, 51.59%, fusha e Transportit Publik ka vlerën prej 46.93%.

Kapitulli II

II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023

1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2023 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 34 komuna, megjithëse shkalla e pavarshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

Sqarim: Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2023 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 80.00%. Komuna e Deçanit ka nivelin maksimal më të lartë të ralizimit të këtij shërbimi prej 100%.




Fig. 6 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Përmes tre treguesve në SMPK. Tereguesi: kërkesa administrative të shqyrtura gjatë vitit shprehur në % janë 87.62% sikurse kërkesa administrative të shqyrtura brenda afateve ligjore janë 84.79%, kurse shërbime administrative të ofruara online janë po ashtu 67.58%




Fig. 7 Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kriterëve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në këtë fushë është 73.02%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 85.78%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në publikimin e dokumenteve të prokurimit publik shprehur me 67.60%.




Figure 8 Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 72.15%, krahasuar me vitin paraprak prej 85.74%, ose 13.59% më pak në vitin 2023. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përmbushur në masën 80.59%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 86.11%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 81.64% ose 3.78% më shumë se në vitin 2022.

Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, ne nivelin prej 65.29%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të




Fig. 9 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës komunale prokurimit publik.

Figura e mësipërme tregon për 16 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Gjakovë (100%), Glllogoc (100.00%),Kaçanik (100%) Lipjan (100%) Rahovec (100%) Skenderaj (100%) Suharekë (100%). Nën nesataren e vendit sa i përketë ofrimit të këtij shërbimi nga komunat vlen të theksohe se 22 komuna janë mbi mesatare, ndërsa 12 komuna nën mesatare, gjë që trasnparenca e organeve komunale është në fokus të komunave.

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 10 tregues, të aplikuar në vitin 2023. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.79%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Komunat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, që shprehur në përqindje është 84.21%, në këtë tregues komunat janë treguar të suksesshme.




Figure 10 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2023, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 26.08% krahasuar me vitin paraprak që ishte 32.47%, apo 6.39 më e ulët se në vitin paraprak. Te ky tregues vërehet një rënie e lehtë në vitin 2023.




Figure 11 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 89.50%. Treguesi i për nivelin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 46.05%, ky tregues ka nivel mesatar të ofrimit edhe në vitin 2022 ka pas ofrim të përafërt. Treguesi i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditësh në përqindje i shprehur 73.94%, sikurse, Treguesi për nivelin e zbatimit të planit të prokurimit ka vlerën prej 89.50%.

Performancë të mirë komunitet kanë edhe sa i përket treguesit, pezullimi i zyrtarëve në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre që ka vlerën prej 93.94%, ka dëshmon se komunitet nuk kanë pas suspendime sa i përket aktakuzave eventuale në shërbimin civil komunal. Komunitet ende qendrojnë jo mirë në hartimin e planeve për integritet dhe miratimin nga kuvendi, vlera e treguesit është 52.94%, kjo vlerë mbetet e ulët.




Figure 12 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 13 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal




Figure 14 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Rahovecit (94.85%) Glllogoc (93.28%) Lipjanit (92.72%), Suharekës (90.42%) Skenderaj (88.56%) dhe Hani Elezit (87.85%) Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovica e Veriut, Partesh, Mamushë, Graçanicë, Prishtinë dhe Ranillug, Shtërpcë. Në nivelin të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 49.71%.




Figure 15 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare




Figure 16 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, treguesi ka vlerën prej 26.88%. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për të gjitha komunat në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 43.32% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 73.71%. Treguesi sa i përket zyrtarëve publik të punësuar nga komuniteti jo shumicë në institucionet komunale ka vlerën 44.31%.

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.70%. Vlenë të theksohet se 11 komuna kanë vlerë maksimale të ofrimit të këtij shërbimi prej 100%, ndërsa 6 komuna mbetën në vlerën 0 për këtë shërbim.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën kulturë, rini dhe sport

Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 57.82%, kurse hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banorëve në komuna është 67.58%.




Figure 18 Treguesit e performancës në fushën e kulturë, rini dhe sport

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 69.30%. Rezultate maksimale prej 100% në vitin 2023 kanë arritur 14 komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive, ndërsa në nivel minimal mbeten 4 komuna, kurse mbi mesatare të vendit janë 18 komuna.




Fig. 19 Krahasimi i performancës së komunave në fushën menaxhimi i fatkeqësive

Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushë është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 78.91% ndërsa në nivel mesatar të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 59.68%, krahasuar me vitin praparak është më e lartë prej 36.93%. Kjo tregon që komunat në vitin 2023 i kanë kushtuar rëndësi realizimit të planit për reagim emergjent.




Fig. 20 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimi fatkeqësive

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

